

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BRO COMPANY” SHPK**

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot më datë 07.03.2024 ne të nënshkruarit:

1. **Marjus Zizaj**, lindur në Durrës, i datëlindjes 15.04.1988, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me numër identifikimi I80415102K
2. **Klinton Zizaj**, lindur në Tiranë, i datëlindjes 15.12.1995, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me numër identifikimi J51215055L
3. **Alvaro Zizaj**, lindur në Manëz, i datëlindjes 21.07.1990, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me numër identifikimi J00721078S
4. **Giorgio Rossetti**, lindur në Milano, Itali, i datëlindjes 11.10.1954, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me numër identifikimi kartë identiteti CA17104KL

themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin:

“BRO COMPANY” SHPK

Shoqëria rregullon veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare”

Neni 2: Selia

Selia e shoqërisë do të jetë:

Rrushkull, Sukth, Rruga Deti, Zona Kadastrale 3241, Nr. Pasurie 1018/34/1, Durrës.

Shoqëria mund të hapë filiale, degë apo përfaqësi në të gjithë territorin shqiptar dhe jashtë vendit.

Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj si vijon:

Veprimitari në fushën e ndërtimit, ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore si ndërtime të banesave, objekteve sociale, rikonstruksione, prodhim materiale ndërtimi, punime infrastrukture, rehabilitim, restaurim, punime rrugësh, ujësjellësa e kanalizime, vepra arti rrugore dhe hekurudhore, rehabilitime rrugësh, porte, aeroporte,etj. Gërmime dheu me punime eventuale murature e betonarme. Prodhim materiale inerte - gurë. Punime karpenterie metalike.

Prodhim, tregtim i materialeve të ndërtimit brenda dhe jashtë vendit për vete dhe për të tretë, ndërtim të impianteve dhe të stabilimenteve për prodhimin dhe furnizimin e lëndëve të para dhe të materialeve të ndërtimit të çdo lloji.

Veprimitari në fushën e turizmit, me qëllim ngritjen e hoteleve dhe fshatrave turistike të pushimit, plazheve, qendrave të argëtimit brenda dhe jashtë vendit, të blejë, të marrë me qera, të ndërtoje apo të nxisë ndërtimin e tyre, duke vepruar në këtë fushë e vetme apo me partnerë të tjera.

Për të vetmin qëllim të arritjes së objektit të lartpërmendor, shoqëria mund të blejë interesa, aksione, pjesëmarrje të kapitalit, në shoqëri të tjera, konsorciume ose kompani të cilat kanë objekte të ngjashëm apo analogë me

të vetin dhe të kryejë të gjitha veprimet komerciale, industriale, financiare. Në veçanti, shoqëria, mund të marrë në pronësi, uzufruktose qera, kompani ose degë kompanish që operojnë në fushën e një ose më shumë prej veprimitarive të mësipërme.

Gjithmonë, për të vetmin qëllim të arritjes së objektit të lartpërmendur, shoqëria mundet gjithashtu të japë garanci, garanci mbi kreditë dhe depozitat, të lerë peng të mira dhe vlera të tundshme, të vendosë garanci hipotekore mbi të mirat e patundshme dhe të tundshme të regjistruesha dhe të vendosë në përgjithësi çdo garanci të mundshme reale dhe personale.

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali i shoqërisë është **500.000** (pesëqindmijë) lekë, i ndarë në 4 kuota. Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

1. **Marjus Zizaj**, është zotëruar i 1 kuote, me 30% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë, me vlerë 150.000 lekë
2. **Klinton Zizaj**, është zotëruar i 1 kuote, me 30% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë, me vlerë 150.000 lekë
3. **Alvaro Zizaj**, është zotëruar i 1 kuote, me 30% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë, me vlerë 150.000 lekë
4. **Giorgio Rossetti** është zotëruar i 1 kuote, me 10% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë, me vlerë 50.000 lekë

Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë **Alvaro Zizaj** për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

Shqiptar: Shqipshqip.com

Neni 7: Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.


Neni 8: Dispozitat e fundit

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e këtij akti.


Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë akt apo në statutin e shoqërisë, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakëve të Shoqërisë

Marjus Zizaj



Alvaro Zizaj



Klinton Zizaj



Giorgio Rossetti

